

V E N D I M
Nr.208, datë 28.4.1999

**PËR FINANCIMIN NGA BUXHETI I SHTETIT TË KUOTËS, QË PAGUAJNË NË HOTELET
E USHTARAKËVE, USHTARAKËT E SISTEMIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përballimi i shpenzimeve për një natë fjetjeje në hotelet e ushtarakëve bëhet sipas një raporti të përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes me Ministrinë e Financave, për pjesën e kostos që duhet të paguhet nga vetë ushtarakët, beqarë e të transferuar, që flenë në hotelet e ushtarakëve, dhe diferencën, që do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

2. Efektet financiarë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 1999 për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 30.6.1978 "Për krijimin e ndërmarrjes së ushqimit social të Shtëpisë së Ushtarakëve, Tiranë, dhe funksionimin e sektorëve të ushqimit social të veshmbathjes, në rrethe" shfuqizohet.

4. Ky vendim i shtrin efektet nga data 1.1.1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko